



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË
Fakulteti i Edukimit

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
FAKULTETI I EDUKIMIT

Emri i punës dhe dt. 11.06.2021			
Njesia organ.	Numer	Nr. Ekzempl.	Vlera
	195/1		

Nr. Prot. _____ Dt. _____

KËSHILLI I FAKULTETIT TË EDUKIMIT, në mbështetje të nenit 72 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, nenit 22 pika 1 të Rregullores mbi zgjedhjet në Universitetin e Mitrovicës dhe punën e Këshillit të Fakultetit, në kuadër të kompetencave ligjore më datë 11.06.2021 merr këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** Udhëzuesi për zhvillimin e provimit final dhe përfundimtar në Fakultetin e Edukimit, Bachelor.
- II. Qëllimi i Udhëzuesit është të ofroj informata në lidhje me mënyrën e zhvillimit të provimit, organizimin e provimit, procedurat e realizimit, procedurat e vlerësimit, shpallja e rezultateve deri në diplomimin e studentëve.
- III. Udhëzuesi shërben për programin Parashkollor dhe programin Fillor.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ju dërgohet:
Arkivës të Fakultetit.
Dekanit të FEdu
Sekretarit të FEdu

Prof.Ass. Dr. Besim GOLLOPANI
Kryesues i Këshillit të Fakultetit



UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
FAKULTETI I EDUKIMIT

Pranuar me dt. 11.06.2021			
Njesia organ.	Numer	Nr.Ekzempl.	Vlera
UNIVERSITETI "ISA BOLETINI"	195/1		

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI"
FAKULTETI I EDUKIMIT
MITROVICË



UDHËZUES
PËR MBAJTJEN E PROVIMIT FINAL NË FAKULTETIN E EDUKIMIT, BACHELOR

Qershor, 2021

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Komisioni i provimit final për programin Fillor dhe Parashkollor
3. Paraqitja dhe organizimi i provimit
4. Vlerësimi i provimit
5. Shtojcat

Hyrje

Fakulteti i Edukimit synon të përgatisë edukatorë dhe mësimdhënës bashkëkohor që i përgjigjen kërkesave të shekullit 21, ku përmes provimit synon ti vlerësoj njohuritë, shkathhtësitë, qëndrimet, vlerat dhe kompetencat të cilat studentet i kanë përfutuar gjatë studimeve katër vjeçare.

Qëllimi i këtij Doracakut është të ofroj informata në lidhje me mënyrën e mbajtjes së provimit, organizimin e provimit, procedurat e realizimit, procedurat e vlerësimit, shpalljen e rezultateve deri në diplomimin e studenteve.

Komisioni i provimit

Komisioni për mbajtjen e provimit final dhe përfundimtar (tash e tutje provimit) emërohet për çdo afat të rregullt të provimeve (tri herë brenda vitit akademik) për programin Parashkollor dhe Fillor, përveçse në rastet kur Këshilli i Fakultetit nuk vendos ndryshe.

Këshilli i Fakultetit të Edukimit emëron komisionin për mbajtjen e provimit në përbërje prej tre anëtarëve nga radhët e profesorëve, të përberë prej kryesuesit dhe dy anëtarëve. Kryesuesi duhet të ketë të paktën gradën akademike dhe shkencore Prof. ass. dr. dhe të jetë bartës i gruplëndëve nga të cilat do të mbahet provimi.

Pjesë i këtij komisioni emërohet edhe një anëtar rezervë në rast mungese të ndonjë anëtari nga komisioni për arsye të caktuara.

Me kërkesë të Komisionit për mbajtjen e provimit, mësimmshënësit e gruplëndëve të përcaktuara për vlerësimin e provimit final janë të obliguar t'i përgjigjen kërkesës së Komisionit për përgatitjen e pyetjeve dhe përgjigjeve për provimin brenda çdo afati të përcaktuar.

Bartësit e këtyre gruplëndëve, përgatisin një listë të literaturës, e cila ju ofrohet studentëve të paktën tri (3) javë para datës së provimit.

Bartësit e gruplëndëve, përgatisin një listë të pyetjeve (deri në 20 pyetje dhe përgjigje) në çdo afat të provimeve dhe të njëjtën e dorëzojnë te kryesuesi i komisionit të provimit, në ditën e mbajtjes së provimit.

Komisioni për mbajtjen e provimit, ka përgjegjësinë e hartimit të testit vlerësues nga pyetjet e gruplëndëve. Provimi final përmbanë 25 pyetje dhe 2 modele të planifikimeve të njëjësive mësimore.

Provimi përgatitet dhe printohet në datën kur mbahet provimi dhe për këtë përgjegjës është komisioni për mbajtjen e provimit.

Komisioni për mbajtjen e provimit dhe referenti e verifikojnë listën e studentëve që do të hyjnë në provim, sigurojnë mbarëvajtjen e provimit, respektojnë kohën e konsultimeve, bëjnë vlerësimin dhe shpallin rezultatet preliminare në tabelën informuese dhe sigurojnë vendosjen e notës në SMU brenda 5 ditësh, nga dita e mbajtjes së provimit. Për secilin student që i nënshtrohet provimit, komisioni është i obliguar ta plotësojë dhe paraqes procesverbalin e nënshkruar në shërbimin e studentëve.

Paraqitja dhe organizimi i provimit

Studentët i nënshtrohen provimit individualisht, duke kontrolluar (vërtetuar) se aftësitë teorike, shkathtësitë praktike dhe vlerat e arritura gjatë kohës së studimeve mund të shfrytëzohen me sukses në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Fletëparaqitja e provimit merret në shërbimin e studentëve, studenti duhet të paraqet provimin dhjetë (10) ditë para mbajtjes së provimit.

Studentët mund ta paraqesin provimin vetëm atëherë kur i kanë mbaruar të gjitha provimet, të vërtetuara në shërbimin e studentëve dhe nga prodekani për mësim. Studentët provimin e paraqesin në formular të veçantë, në të cilin, përveç shënimeve të studentit/es vendoset edhe data e paraqitjes së provimit. Në pjesën e dytë të formularit shkruhet: data e lejimit të paraqitjes së provimit, data e provimit (afati) dhe komisioni për vlerësim. Të gjitha të dhënat vërtetohen nga shefi i departamentit dhe prodekani për mësim i Fakultetit. Në fund të formularit, referenti vërteton se studenti ka fituar të drejtën për të paraqitur provimin.

Pas përfundimit të semestrit të fundit, studentet provimin final duhet ta përfundojnë brenda 12 muajve, (pasi t'i kenë përfunduar të gjitha provimet). Nëse studenti nuk mund të përfundojë provimin final brenda dymbëdhjetë muajve (12) mund të kërkojë edhe një herë nga dekani i njësisë akademike për vazhdimin e periudhës së diplomimit edhe për 12 muaj tjerë.

Provimi mbahet në javën e fundit të afatit të rregullt të provimeve. Provimi final mbahet me shkrim, nëse për një gjë të tillë nuk vendos ndryshe Këshilli i Fakultetit. Pyetjet mund të jenë të hapura, me zhvillim ose me zgjidhje.

Testi plotësohet nga studentët me laps kimik (stilolaps) me ngjyrë të kaltër dhe duhet të përmbajë këto të dhëna: emrin dhe stemën e Universitetit, emrin e Fakultetit, emrin, mbiemrin dhe nr. e ID të studentit, datën, vendin e mbajtjes së provimit, udhëzimet mbi plotësimin e provimit, vlerësimin e secilës pyetje me pikë, nënshkrimin e studentit dhe anëtarëve të komisionit. Provimi përgatitet në gjuhën shqipe, por lejohet përdorimi i termave të njohur nga gjuha angleze. Provimi duhet të jetë i strukturuar në mënyrë logjike sipas përmbajtjes së pyetjeve.

Vlerësimi i provimit

Përmes provimit studentët do të vlerësohen për njohuritë, shkathhtësitë, qëndrimet, vlerat dhe kompetencat të cilat i kanë përfituar gjatë studimeve katër vjeçare.

Provimi do të përmbajë pyetje nga lëndët bazë të profesionit, të shprehura në specifikat e kompetencave/standardeve të mësimdhënësve për fazën para shërbimit sipas Kornizës Strategjike të përgatitjes së mësimdhënësve në Kosovë.

Gruplëndët duhet të prezantohen në test përmes një përqindje të shpërndarjes së pyetjeve të barabartë:

Lëndët për programin Parashkollor

- | | |
|--|-------|
| 1. Gruplëndët kurrikulare dhe SZHMFH | (10%) |
| 2. Metodologjitë e edukimit të hershëm | (20%) |
| 3. Monitorimi dhe vlerësimi në edukim të hershëm | (20%) |
| 4. Gruplëndët e psikologjisë | (20%) |
| 5. Planifikimi në edukim të hershëm | (20%) |
| 6. Gjithëpërfshirja dhe komunikimi | (10%) |

Lëndët për programin Fillor:

- | | |
|--|-------|
| 1. Gruplëndët kurrikulare | (20%) |
| 2. Gruplëndët e metodologjisë së mësimin | (20%) |
| 3. Gruplëndët e psikologjisë | (20%) |
| 4. Gruplëndët për vlerësimin në arsim | (10%) |
| 5. Planifikimi në programin Fillor | (20%) |
| 6. Gjithëpërfshirja dhe komunikimi | (10%) |

Vlerësimi i provimit final bëhet përmes notës, si çdo provim tjetër e cila fitohet me pikët e arritura në provim. Provimi vlerësohet me 100 pikë në total. Vlerësimi bëhet me notë sipas Statutit të UIBM. Vendosjen e notës në SMU e bënë komisioni, pas përfundimit të procedurave të lartcekura, në afat prej 5 ditësh të punës nga dita e mbajtjes së provimit.

Përcaktimi i notës përfundimtare të provimit:

Pikët	Nota	Përshkrimi	ECTS Nota
91-100%	10	Shkëlqyeshëm	A
81-90%	9	Shumë mirë	B
71-80%	8	Mirë	C
61-70%	7	Kënaqshëm	D
51-60%	6	Mjaftueshëm	E
0-50%	5	Dobët	FX/F

Studenti konsiderohet se ka kaluar me sukses provimin, kur vlerësohet nga nota 6 deri në 10, ndërsa konsiderohet se nuk e ka kaluar provimin kur vlerësohet me notën 5.

Studenti/ja që vërtetohet se ka bërë shkelje të rregullave në provim, referohet në komision disiplinor dhe provimi bëhet i pavlefshëm.

Studenti që i jep të gjitha provimet e parapara me planin mësimor dhe i kryen obligimet tjera të parapara me akte normative të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë dhe Fakultetit të Edukimit, si dhe e mbron me sukses provimin, fiton gradën akademike bachelor në programin përkatës.

Pas publikimit të rezultateve finale nga ana e komisionit, studentët kanë të drejtë në afat prej tre ditësh të kërkojnë konsultime me anëtarët e komisionit rreth rezultatit të treguar, nëse eventualisht ka ndonjë gabim teknik në kalkulim, mirëpo jo edhe t’i nënshtrohen provimit për ngritje note apo të ngjashme. Pas përfundimit të konsultimeve, komisioni shpallë rezultatet përfundimtare të provimit. Kryetari i komisionit obligohet që brenda afatit të vendos notën në SMU.

Ky Udhëzues hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Këshilli i Fakultetit të Edukimit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë.

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Udhëzuesi bëhen në mënyrën në të cilën është miratuar.

Udhëzuesi vlen deri në aprovimin nga Senati i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, të Rregullores për mbajtjen e provimit në Fakultetin e Edukimit.



**UNIVERSITETI/UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
FAKULTETI I EDUKIMIT
MITROVICË**

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

Informatë për studentët

PROCEDURAT PËR PARAQITJEN E PROVIMIT FINAL PËR NIVELIN E STUDIMEVE BACHELOR

1. Kërkesa për verifikimin e notave

Studenti/ja, që i ka dhënë të gjitha provimet aplikon përmes SMU-së, e paraqet dhe merr kërkesën për verifikim të notave në shërbimin për çështje të studentëve) para provimit.

2. Paraqitja e provimit final

Pas verifikimit të notave, studenti/ja e paraqet provimin final. Formularit 1 i bashkëngjitet pasqyra e notave të verifikuara.



UNIVERSITETI/UNIVERSITY

"ISA BOLETINI"

FAKULTETI I EDUKIMIT

MITROVICË

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

SHËRBIMI PËR ÇËSHTJE TË STUDENTËVE

I - KËRKESË PËR VERIFIKIMIN E NOTAVE NË BACHELOR

Pasi që i kam dhënë të gjitha provimet e parapara me Statutin e UIBM-it dhe Rregulloren për studimet themelore - bachelor të Fakultetit të Edukimit, Programi:, kërkoj nga shërbimi i administratës për çështje të studentëve, të më lëshojë pasqyrën e notave, dhe pas verifikimit të jap pëlqimin se e kam fituar të drejtën e paraqitjes së kërkesës për provimin final.

TË DHËNAT E STUDENTIT	
Emri (emri i prindit) dhe mbiemri	
Adresa e përhershme	
Nr. telefonit/E-mail	
ID Regjistri	
Programi i studimeve	
Nënshkrimi i studentit/es	
Vërejtje	

Pas verifikimit të notave në SMU si dhe raporteve të provimeve, shërbimi i administratës për çështje të studentëve, jep këtë :

P Ë L Q I M

Kandidati-ja _____ i ka dhënë të gjitha provimet e parapara sipas Statutit të UIBM, Rregulloreve për studimet themelore-bachelor të Fakultetit të Edukimit, Programi.....dhe i plotëson kushtet për paraqitjen e kërkesës për të hyrë në provimin final.

Dt. ____ . ____ .2021

Zyrtari i administratës
